REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr. ________ Prot. Tiranë, më ___.___.2024

***PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR***

***(Mbledhje e realizuar me video konferencë)***

***(Mbajtur, më 11.10.2023)***

***Pika 1 e rendit të ditës me objekt:*** Shqyrtimi i projektvendimit "Për transferimin e gjyqtares znj. {...} në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan", i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 13:09 dhe mbaroi në orën 13:20.***

Në mbledhje ishin të pranishëm nëpërmjet platformës* dhe në sallë:

1. ***Naureda Llagami*** ***(kryetare)***
2. ***Klodian Kurushi*** ***(anëtar)***
3. ***Fatmira Luli*** ***(anëtare)***
4. ***Irena Plaku*** ***(anëtare)***
5. ***Dritan Hallunaj*** ***(anëtar)***
6. ***Ridvan Hado*** ***(anëtar)***
7. ***Alban Toro*** ***(anëtar)***
8. ***Marçela Shehu*** ***(anëtare)****
9. ***Brikena Ukperaj*** ***(anëtare)****
10. ***Yllka Rupa*** ***(anëtare)****

***Shënim:*** Nuk mori pjesë në këtë çështje të rendit të ditës, anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. Ilir Rusi (zëvendëskryetar).

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

***1. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.***

***2. Luan Dibra, Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.***

***3. Denisa Varfi, Përfaqësuese e MD-së.***

***4. Valbona Bala, Eksperte (EWMI-INL).***

***5. Edmond Hoxhaj (Birn).***

***9. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.***

**RENDI I DITËS:**

1. Shqyrtimi i projektvendimit "Për transferimin e gjyqtares znj. {...} në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan", i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

***Naureda Llagami***: Përshëndetje!

Siç jeni vënë në dijeni, po zhvillojmë mbledhjen e radhës të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Në fakt kjo është një mbledhje prioritare duke qenë se një nga prioritetet që ka Këshilli është emërimi i magjistratëve dhe mbledhja e thirrur sot me karakter urgjent është në vazhdën e të gjithë veprimeve/masave që po merr Këshilli për emërimin e 40 magjistratëve, të cilët shumë shpejt do të jenë brenda javës tjetër të emëruar dhe të caktuar.

Pa humbur kohë fjalën ia jap zotit Kurushi mbi relatimin e projekt-akteve.

***Klodian Kurushi***: Faleminderit zonja Kryetare!

Pa humbur kohë po filloj me relacionin e parë mbi projektvendimin "Për

transferimin e gjyqtares znj. {...} në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan".

Në vijim të procedurës së lëvizjes paralele, me vendimin nr. 491, datë 21.09.2023, Këshilli ka vendosur ndër të tjera edhe miratimin e renditjes së kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele për një pozicion të lirë të shpallur me Vendimin nr. 253, datë 24.05.2023. Në këtë renditje rezultoi se zonja {...} të ishte e para, dhe e dyta zonja {...}.

Pas procedurës së ndjekur për renditjen e kandidatëve, Komisioni vijoi më tej procedurat për lëvizjen paralele. Kështu që ky vendim, vendimi i shpallur në datë 24.05.2023 ka marrë formë të prerë dhe Komisioni ka hartuar projektvendimin përkatës për transferimin e zonjës {...} në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan. Bashkëlidhur relacionit është projektvendimi përkatës, që besoj janë njohur të gjithë kolegët.

***Naureda Llagami***: Kemi ndonjë diskutim, sepse kemi dhe kolegët e tjerë online? Nëse nuk kemi, kalojmë në votim.

***Irena Plaku***: Pro.

***Dritan Hallunaj***: Pro.

***Ridvan Hado***: Dakord.

***Alban Toro***: Dakord.

***Fatmira Luli***: Dakord.

***Naureda Llagami***: Marçela.

***Marçela Shehu***: Dakord.

***Naureda Llagami***: Yllka.

***Yllka Rupa***: Pro.

***Naureda Llagami***: Brikena.

***Brikena Ukperaj***: Pro.

***Klodian Kurushi***: Dakord me projektvendimin, duke shtuar tek pjesa e fundit efektet juridike të këtij vendimi fillojnë më datë 16.10.2023, siç e kishim diskutuar edhe në mbledhjen e fundit. Faleminderit!

***Naureda Llagami***: Dakord me propozimin dhe me aktin.

Atëherë, Këshilli miraton projekt-aktin sipas propozimit të ardhur nga Komisioni përkatës.

*          *          *

(Pika 1 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**

Nr. ________ Prot. Tiranë, më ___.___.2024

***PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR***
***(Mbledhje e realizuar me video konferencë)***

***(Mbajtur, më 11.10.2023)***

***Pika 2 e rendit të ditës me objekt***: Shqyrtimi i projektvendimit "Për transferimin e gjyqtares znj. {...} në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë", i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 13:09 dhe mbaroi në orën 13:20.***

Në mbledhje ishin të pranishëm nëpërmjet platformës* dhe në sallë:

1. ***Naureda Llagami*** ***(kryetare)***
2. ***Klodian Kurushi*** ***(anëtar)***
3. ***Fatmira Luli*** ***(anëtare)***
4. ***Irena Plaku*** ***(anëtare)***
5. ***Dritan Hallunaj*** ***(anëtar)***
6. ***Ridvan Hado*** ***(anëtar)***
7. ***Alban Toro*** ***(anëtar)***
8. ***Marçela Shehu*** ***(anëtare)****
9. ***Brikena Ukperaj*** ***(anëtare)****
10. ***Yllka Rupa*** ***(anëtare)****

***Shënim:*** Nuk mori pjesë në këtë çështje të rendit të ditës, anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. Ilir Rusi (zëvendëskryetar).

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

***1. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.***

***2. Luan Dibra, Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.***

***3. Denisa Varfi, Përfaqësuese e MD-së.***

***4. Valbona Bala, Eksperte (EWMI-INL).***

***5. Edmond Hoxhaj (Birn).***

***9. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.***

**RENDI I DITËS:**

2. Shqyrtimi i projektvendimit "Për transferimin e gjyqtares znj. {...} në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë", i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

***Naureda Llagami***: Kalojmë tek projekt-akti i dytë që ka të bëjë me transferimin e gjyqtares znj. {...} në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë. Sërish zoti Kurushi.

***Klodian Kurushi***: Faleminderit!

Me vendimin nr. 510, datë 05.10.2023, Këshilli ndër të tjera ka vendosur miratimin e renditjes së kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele për vendin e shpallur me vendimin nr. 17, datë 18.01.2023, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë. Në këtë renditje rezultoi se zonja Kape u rendit e para dhe zoti {...} u rendit i dyti në këtë procedurë.

Ky vendim ka marrë formë të prerë dhe mbi këtë bazë Komisioni ka hartuar projektvendimin për transferimin e zonjës Kape në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë. I njëjti propozim

është edhe për datën. Ne propozojmë datën 16.10, dita kur do të hyjnë efektet e projektvendimit të propozuar nga ana jonë. Faleminderit!

***Naureda Llagami***: Faleminderit!

Atëherë kalojmë në votimin e projekt-aktit sipas propozimit të ardhur, me gjithë datën 16 tetor.

***Irena Plaku***: Pro.

***Dritan Hallunaj***: Pro.

***Ridvan Hado***: Dakord.

***Alban Toro***: Dakord.

***Fatmira Luli***: Dakord.

***Naureda Llagami***: Marçela.

***Marçela Shehu***: Dakord.

***Naureda Llagami***: Yllka.

***Yllka Rupa***: Pro.

***Brikena Ukperaj***: Pro.

***Klodian Kurushi***: Dakord.

***Naureda Llagami***: Dakord.

Miratohet projekt-akti sipas propozimit.

*   *   *

(Pika 2 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**

Nr. ________ Prot. Tiranë, më ___.___.2024

***PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR***
***(Mbledhje e realizuar me video konferencë)***

***(Mbajtur, më 11.10.2023)***

***Pika 3 e rendit të ditës me objekt****:* Shqyrtimi i projektvendimit "Për transferimin e përkohshëm të gjyqtares znj. {...} në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës", i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 13:09 dhe mbaroi në orën 13:20.***

Në mbledhje ishin të pranishëm nëpërmjet platformës* dhe në sallë:

1. ***Naureda Llagami*** ***(kryetare)***
2. ***Ilir Rusi*** ***(zëvendëskryetar)***
3. ***Klodian Kurushi*** ***(anëtar)***
4. ***Fatmira Luli*** ***(anëtare)***
5. ***Irena Plaku*** ***(anëtare)***
6. ***Dritan Hallunaj*** ***(anëtar)***
7. ***Ridvan Hado*** ***(anëtar)***
8. ***Alban Toro*** ***(anëtar)***
9. ***Marçela Shehu*** ***(anëtare)****
10. ***Brikena Ukperaj*** ***(anëtare)****

***11. Yllka Rupa (anëtare)****

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

***1. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.***

***2. Luan Dibra, Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.***

***3. Denisa Varfi, Përfaqësuese e MD-së.***

***4. Valbona Bala, Eksperte (EWMI-INL).***

***5. Edmond Hoxhaj (Birn).***

***9. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.***

**RENDI I DITËS:**

3. Shqyrtimi i projektvendimit "Për transferimin e përkohshëm të gjyqtares znj. {...} në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës", i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

***Naureda Llagami***: Kalojmë tek projekt-akti tjetër që ka të bëjë me transferimin e përkohshëm të gjyqtares znj. {...} në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.

***Klodian Kurushi***: Në fakt janë katër relacione në radhë që i referohen situatës së transferimit të përkohshëm të gjyqtarëve sipas propozimeve përkatëse.

Unë po referoj relacionin e parë, ndërkohë që relacionet e tjera janë i njëjti model me këtë të parin.

"Për transferimin e përkohshëm të gjyqtares znj. {...} në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës".

Këshilli i Lartë Gjyqësor me Vendimin nr. 512 datë 05.10.2023 hapi procedurën për transferimin e përkohshëm për një pozicion të lirë në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, ndër të tjera në këtë thirrje ne kemi shpallur pozicionin e lirë në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës

për transferim të përkohshëm me një afat 1-vjeçar dhe kjo shpallje iu drejtua znj. {...}, aktualisht gjyqtare në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë, e cila u ftua për të dhënë pëlqimin për transferimin e përkohshëm.

Më datë 05.10.2023 në rrugë elektronike, znj. {...} është njoftuar për vendimin e sipërpërmendur. Në përputhje me përmbajtjen e pikës 2 të vendimin nr. 512 datë 05.10.2023 gjyqtares znj. {...} i është drejtuar ftesa për dhënie pëlqimi për transferimin të përkohshëm në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.

Më datë 06.10.2023, gjyqtarja znj. {...} në rrugë elektronike ka paraqitur një deklaratë ku shpreh pëlqimin për transferimin e përkohshëm në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.

Në bazë të nenit 46 të Ligjit nr.96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka kërkuar opinion zëvendëskryetarit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë në lidhje me ngarkesën e punës, në lidhje me pasojat që krijohen për shkak të transferimit të gjyqtares si dhe një propozim për periudhën maksimale sa mund të zgjasë afati i transferimit.

Nga komunikimi i ardhur rezulton se në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë ushtrojnë efektivisht funksionin gjithsej 4 (katër) gjyqtarë dhe zonja Xhani ka një ngarkesë të përgjithshme prej 240 dosjesh.

Opinioni i kryetarit jep pëlqimin për të gjitha kërkesat dhe transferimi nuk dëmton funksionalitetin e gjykatës, afati njëvjeçar është i pranueshëm si dhe ngarkesa nuk do të përbëjë problem për t'iu shpërndarë gjyqtarëve të tjerë, pra nuk përbën problem për funksionalitetin dhe vijueshmërinë e çështjeve.

Ndodhur në këto kushte, përveç opinionit, Komisioni bëri edhe vlerësimet e tij dhe konkludon që është e pranueshme përdorimi i skemës së transferimit të përkohshëm të gjyqtares në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.

Bashkëlidhur relacionit ne propozojmë edhe projektvendimin përkatës i cili mendojmë që duhet miratuar nga mbledhja.

Faleminderit për vëmendjen!

***Naureda Llagami***: Nëse nuk kemi diskutime, kalojmë në votim.

Meqë zoti Rusi u përfshi në mbledhje.

***Ilir Rusi***: Dakord.

***Irena Plaku***: Pro.

***Dritan Hallunaj***: Pro.

***Ridvan Hado***: Dakord.

***Alban Toro***: Dakord.

***Fatmira Luli***: Dakord.

***Marçela Shehu***: Dakord.

***Yllka Rupa***: Pro.

***Brikena Ukperaj***: Pro.

***Klodian Kurushi***: Dakord.

***Naureda Llagami***: Dakord.

Miratohet projekt-akti sipas propozimit.

* * *

(Pika 3 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**

Nr. ________ Prot. Tiranë, më ___.___.2024

***PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR***
***(Mbledhje e realizuar me video konferencë)***

***(Mbajtur, më 11.10.2023)***

***Pika 4 e rendit të ditës me objekt****:* Shqyrtimi i projektvendimit "Për transferimin e përkohshëm të gjyqtarit z. {...} në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë", i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 13:09 dhe mbaroi në orën 13:20.***

Në mbledhje ishin të pranishëm nëpërmjet platformës* dhe në sallë:

1. ***Naureda Llagami*** ***(kryetare)***
2. ***Ilir Rusi*** ***(zëvendëskryetar)***
3. ***Klodian Kurushi*** ***(anëtar)***
4. ***Fatmira Luli*** ***(anëtare)***
5. ***Irena Plaku*** ***(anëtare)***
6. ***Dritan Hallunaj*** ***(anëtar)***
7. ***Ridvan Hado*** ***(anëtar)***
8. ***Alban Toro*** ***(anëtar)***
9. ***Marçela Shehu*** ***(anëtare)****
10. ***Brikena Ukperaj*** ***(anëtare)****

***11. Yllka Rupa*** ***(anëtare)****

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

***1. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.***

***2. Luan Dibra, Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.***

***3. Denisa Varfi, Përfaqësuese e MD-së.***

***4. Valbona Bala, Eksperte (EWMI-INL).***

***5. Edmond Hoxhaj (Birn).***

***9. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.***

**RENDI I DITËS:**

4. Shqyrtimi i projektvendimit "Për transferimin e përkohshëm të gjyqtarit z. {...} në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë", i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

***Naureda Llagami***: Kalojmë tek projekt-akti i radhës që ka të bëjë me transferimin e z. {...}. Të njëjtin relacion kemi.

***Klodian Kurushi***: Është i njëjti relacion.

Bashkëlidhur është projektvendimi me të njëjtën strukturë me atë që thashë më lart (*i referohet projektvendimit të miratuar në pikën 3 të rendit të ditës*).

***Naureda Llagami***: Jemi dakord?

***Ilir Rusi***: Dakord.

***Irena Plaku***: Pro.

***Dritan Hallunaj***: Pro.

***Ridvan Hado***: Dakord.

***Alban Toro***: Dakord.

***Fatmira Luli***: Dakord.

***Marçela Shehu***: Dakord.

***Yllka Rupa***: Pro.

***Brikena Ukperaj***: Pro.

***Klodian Kurushi***: Dakord.

***Naureda Llagami***: Dakord.

Miratohet.

*          *          *

(Pika 4 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr. ________ Prot. Tiranë, më ___.___.2024

***PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR***

***(Mbledhje e realizuar me video konferencë)***

***(Mbajtur, më 11.10.2023)***

***<u>Pika 5 e rendit të ditës me objekt</u>:*** Shqyrtimi i projektvendimit "Për transferimin e përkohshëm të gjyqtarit z. {...} në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan", i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 13:09 dhe mbaroi në orën 13:20.***

Në mbledhje ishin të pranishëm nëpërmjet platformës* dhe në sallë:

1. ***Naureda Llagami*** ***(kryetare)***
2. ***Ilir Rusi*** ***(zëvendëskryetar)***
3. ***Klodian Kurushi*** ***(anëtar)***
4. ***Fatmira Luli*** ***(anëtare)***
5. ***Irena Plaku*** ***(anëtare)***
6. ***Dritan Hallunaj*** ***(anëtar)***
7. ***Ridvan Hado*** ***(anëtar)***
8. ***Alban Toro*** ***(anëtar)***
9. ***Marçela Shehu*** ***(anëtare)****
10. ***Brikena Ukperaj*** ***(anëtare)****

***11. Yllka Rupa*** ***(anëtare)****

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

***1. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.***

***2. Luan Dibra, Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.***

***3. Denisa Varfi, Përfaqësuese e MD-së.***

***4. Valbona Bala, Eksperte (EWMI-INL).***

***5. Edmond Hoxhaj (Birn).***

***9. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.***

**RENDI I DITËS:**

5. Shqyrtimi i projektvendimit "Për transferimin e përkohshëm të gjyqtarit z. {...} në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan", i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

***Naureda Llagami***: Kalojmë tek projekt-akti tjetër që ka të bëjë me transferimin e përkohshëm me pëlqim të z. {...}, me të njëjtat rrethana.

***Klodian Kurushi***: Faleminderit zonja Kryetare!

Është e njëjta situatë. Kemi marrë edhe opinionin përkatës. Ndodhemi në të njëjtat kushte dhe ne propozojmë transferimin e përkohshëm të gjyqtarit z. {...} në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan. Faleminderit!

***Naureda Llagami***: Ilir?

***Ilir Rusi***: Dakord.

***Irena Plaku***: Pro.

***Dritan Hallunaj***: Pro.

***Ridvan Hado***: Dakord.

***Alban Toro***: Dakord.

***Fatmira Luli***: Dakord.

***Marçela Shehu***: Dakord.

***Yllka Rupa***: Pro.

***Brikena Ukperaj***: Pro.

***Klodian Kurushi***: Dakord.

***Naureda Llagami***: Dakord.

Atëherë miratohet edhe ky projekt-akt.

*   *   *

(Pika 5 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**

Nr. ________ Prot. Tiranë, më ___.___.2024

***PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR***

***(Mbledhje e realizuar me video konferencë)***

***(Mbajtur, më 11.10.2023)***

***Pika 6 e rendit të ditës me objekt***: Shqyrtimi i projektvendimit "Për transferimin e përkohshëm të gjyqtarit z. {...} në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë", i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 13:09 dhe mbaroi në orën 13:20.***

Në mbledhje ishin të pranishëm nëpërmjet platformës* dhe në sallë:

1. ***Naureda Llagami*** ***(kryetare)***
2. ***Ilir Rusi*** ***(zëvendëskryetar)***
3. ***Klodian Kurushi*** ***(anëtar)***
4. ***Fatmira Luli*** ***(anëtare)***
5. ***Irena Plaku*** ***(anëtare)***
6. ***Dritan Hallunaj*** ***(anëtar)***
7. ***Ridvan Hado*** ***(anëtar)***
8. ***Alban Toro*** ***(anëtar)***
9. ***Marçela Shehu*** ***(anëtare)****
10. ***Brikena Ukperaj*** ***(anëtare)****
11. ***Yllka Rupa*** ***(anëtare)****

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

***1. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.***

***2. Luan Dibra, Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.***

***3. Denisa Varfi, Përfaqësuese e MD-së.***

***4. Valbona Bala, Eksperte (EWMI-INL).***

***5. Edmond Hoxhaj (Birn).***

***9. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.***

**RENDI I DITËS:**

6. Shqyrtimi i projektvendimit "Për transferimin e përkohshëm të gjyqtarit z. {...} në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë", i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

***Naureda Llagami***: Kalojmë tek projekt-akti i fundit që ka të bëjë me transferimin e përkohshëm me pëlqim të gjyqtarit z. {...}, me të njëjtat shkaqe dhe rrethana relacioni.

***Klodian Kurushi***: E njëjta situatë.

Propozojmë që zoti Lala të transferohet përkohësisht në Gjykatën e Shkallës së Parë Administrative Tiranë për një periudhë njëvjeçare. Faleminderit!

***Naureda Llagami***: Kalojmë në votim?

***Ilir Rusi***: Dakord.

***Irena Plaku***: Pro.

***Dritan Hallunaj***: Pro.

***Ridvan Hado***: Dakord.

***Alban Toro***: Dakord.

***Fatmira Luli***: Dakord.

***Marçela Shehu***: Dakord.

***Yllka Rupa***: Pro.

***Brikena Ukperaj***: Pro.

***Klodian Kurushi***: Dakord.

***Naureda Llagami***: Dakord.

Atëherë, me miratimin e këtij projekt-akti të fundit, mbyllim mbledhjen për sot.

Faleminderit!

*   *   *

(Pika 6 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**